




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.381/2023

Datë: 28 korrik 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 1, pika 1.12 dhe nenit 17, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 313-të, të mbajtur me datë 28 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

I. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.226/2021, i datës 2 shtator 2021, në pikën II dhe IV të dispozitivit, me riformulimin si në vijim:

Pika II: Kryetarja dhe anëtarët e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve do të paguhet në shume fikse të kompensimit mujor, në shumë prej 150 €, sipas kohëzgjatjes së mandatit të tyre”.

Pika IV: Kompensimi sipas paragrafit II të këtij vendimi, do të zbatohet në mënyrë retroaktive vetëm për kryetaren e Komisionit dhe atë nga data 30 prill 2021 e deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/196 për Pagat në Sektorin Publik.

II. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.

III. Vendimi hyn në fuqi me datë 28 korrik 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 28 korrik 2023, ka shqyrtuar kërkesën e Kryetares së Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, lidhur me pretendimet e saj për zbatimin e gabuar të Vendimit KGJK.nr.226/2021, përmes së cilit Kryetarja e këtij Komisioni, nuk përfshihet në kompensimin monetar sikurse anëtarët tjerë të këtij Komisioni.

Pas vlerësimit të kërkesës në fjalë, KGJK-ja me qëllim të trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit të të gjithë anëtarëve të këtij Komisioni, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopja e vendimit i dërgohet:

- Znj. Teuta Ibrahim, Kryetare e KVPGJ;
- Sekretariatit të KGJK-së;
- Arkivit.